

Newsletter COVID-19

Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës në linjë me masat e ndërmarra nga Autoritetet Homologe

Autoriteti Italian i Konkurrencës ka hetuar platforma të shitjeve online lidhur me vendosjen e çmimeve të larta ndaj xhelit dizinfektues dhe maskave mbrojtëse në kuadër të situatës së krijuar në vend.



Autoriteti Spanjoll i Konkurrencës, në linjë me Dekretin Mbretëror i cili ka shpallur gjendjen e jashtëzakonshme, ka pezulluar shumicën e procedurave, por mban të hapur portalin elektronik për procedura për të cilat palët mund të provojnë se shtyrja do të rezultonte në dëm të interesit publik.



Autoriteti Francez i Konkurrencës ka bërë me dije se nuk e ka të mundur garantimin e afateve normale të përqendrimeve pasi stafi është duke punuar nga shtëpia.



Autoriteti i Konkurrencës i Mbretërisë së Bashkuar ka ngritur një task-forcë COVID-19 me qëllim sigurimin e zbatimit të masave në tregjet e prekura nga emergjenca shëndetësore publike si dhe për të këshilluar Qeverinë mbi çështje ligjore gjatë pandemisë.



Autoriteti Australian i Konkurrencës ka lejuar bankat të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën lidhur me një paketë për lehtësimin e biznesit të vogël si pasojë e situatës së krijuar nga COVID-19.



Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës ka vendosur marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore - dezinfektant duarsh, alkool dhe maska, për të cilat kërkesa konsumatore ka qenë në rritje si pasojë e situatës së krijuar nga virusi COVID-19, duke kërkuar: ndalimin e sjelljes së ndërmarrjeve të cilat në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë vendosin çmime apo kushte të padrejta tregtimi; shmangien e abuzimit në zinxhirin e tregtimit; aplikimin e çmimeve të orientuara drejt kostos dhe publikimin e tyre.



Rrjeti Evropian i Konkurrencës European Competition Network



Njoftim i përbashkët i Rrjetit Evropian të Konkurrencës (REC) lidhur me zbatimin e ligjit të konkurrencës përgjatë krizës "CORONA" (*i shqipëruar*).

REK është në dijeni të pasojave socio-ekonomike të shkaktuara nga virusi COVID-19 në territorin e BE-së. Rregullat e konkurrencës sigurojnë një kuadër veprimi të drejtë ndërmjet kompanive. Ky objektivi qëndron edhe në një periudhë kur kompanitë dhe e tërë ekonomia vuajnë pasojat e krizave.

REK mirëkupton se kjo situatë e jashtëzakonshme mund të sjellë nevojën e kompanive për të bashkëpunuar lidhur me sigurimin e furnizimit dhe shpërndarjen e drejtë të produkteve për të cilat ka mungesë në treg. Në këto rrethana, RNK nuk do të ndërhyjë në mënyrë aktive kundrejt masave të përkohshme të nevojshme të vendosura për shmangien e mungesës së ofertës.

Duke marrë parasysh rrethanat aktuale, masat e mësipërme nuk kanë gjasa të jenë problematike, pasi ato ose nuk do të konsideroheshin si kufizim i konkurrencës parashikuar në nenin 101 të Traktatit për Funksonimin e Bashkimit Evropian/53 Zona Ekonomike Evropiane, ose do të gjeneronin efijenca të cilat me shumë gjasa do të jenë më të mëdha sesa kufizimet.

Në rast se kompanitë kanë dyshime mbi përputhjen e këtyre iniciativave bashkëpunuese me TFBE, ato mund t'u drejtohen RNK për udhëzime të mëtejshme.

Njëkohësisht është tejet e rëndësishme që të sigurohet se produktet të cilat konsiderohen si thelbësore në mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve (psh. maska mbrojtëse dhe xhel dizinfektues) të mbeten në dispozicion me çmime konkurruese.

REK nuk do të hezitojë të marrë masa ndaj subjekteve të cilët përfitojnë në mënyrë të padrejtë nga situata e krijuar nëpërmjet kartelizimit ose abuzimit të pozitës dominuese.

Në këtë kontekst, **REK sjell në vëmendje se rregullat ekzistuese i lejojnë prodhuesit të përcaktojnë çmimet tavan për produktet e tyre, të cilat mund të jenë të dobishme në kufizimin e rritjes së pajustificuar të çmimeve nga ana e distributorëve.**

https://ec.europa.eu/competition/ecn/202003_joint-statement_ecn_corona-crisis.pdf

Bashkimi Evropian



Përqendrimet

Drejtoria e Përgjithshme e Konkurrencës e BE (DG Competition) ka marrë një sërë masash për **sigurimin e vazhdimësisë së biznesit** në zbatim të rregullores së BE për përqendrimet, për shkak të kompleksitetit dhe problemeve të shkaktuara nga COVID-19, **kompanitë sugjerohen të shtyjnë në kohë njoftimet e përqendrimeve** të planifikuara deri në një njoftim të dytë, nëse është e mundur.

Kjo pasi:

(1) shërbimet e DP së Konkurrencës kanë gjasa të përballen me vështirësi gjatë mbledhjes së informacionit nga palët e treta, si klientët, konkurrentët dhe furnizuesit gjatë javëve në vazhdim, (2) të gjitha shërbimet e Komisionit mund të përballen me kufizime lidhur me aksesin në informacion dhe databaza si dhe në shkëmbim informacioni si pasojë e masave të marra për të punuar nga shtëpitë.

Dërgimi i informacionit në mënyrë fizike nuk rekomandohet, si dhe në rastet e kryerjes së një dorëzimi fizik duhen kontaktuar personat përgjegjës në DPK pasi operon me staf të reduktuar.

https://ec.europa.eu/competition/mergers/information_en.html

Ndihma Shtetërore

Komisioni i Bashkimit Evropian më datë 19 mars 2020 ka miratuar një **kuadër të përkohëshëm lidhur me masat e ndihmës shtetërore** me qëllim mbështetjen e ekonomisë në kushtet e pandemisë së COVID-19. Ky kuadër do të jetë në fuqi deri në dhjetor 2020. Ai mundëson pesë lloje ndihmash:

- Grante direkte, avantazhe taksative dhe parapagime
- Garanci shtetërore për kredi të marra nga kompanitë në banka
- Subvencionimi i huave publike për kompanitë
- Masa mbrojtëse për bankat të cilat të cilat kanalizojnë ndihmën shtetërore në ekonominë reale
- Sigurimi eksportit të kredive afatshkurtra - Short-term export credit insurance (siguracion lidhur me mospagimin e kredisë nga një klient jo-rezident/i huaj)

https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/IP_20_496

Komisioni gjithashtu ka miratuar ndihmat shtetërore të vendeve anëtare të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e ekonomisë si dhe të ndërmarrjeve të ndryshme si pasojë e situatës së krijuar nga virusi COVID-19.

Janë miratuar skema të ndihmës shtetërore për Danimarkën, Portugalinë, Italinë, Gjermaninë, Francën, Letoninë, Luksemburgun, Spanjën dhe Mbretërinë e Bashkuar.

https://ec.europa.eu/competition/news_en.html